

VENDIM
Nr. 663, datë 26.9.2012

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME NË PRONËSI
TË ALBTELECOM SHA, TË CILAT PREKEN NGA MASTERPLANI I MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 546, DATË 28.5.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E
MASTERPLANIT PËR ZHVILLIMIN E PORTIT TË DURRËSIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga masterplani i miratuar me vendimin nr. 546, datë 28.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e masterplanit për zhvillimin e Portit të Durrësit”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Portual Durrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqe trualli 3 289 (tri mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) m², vlerësuar me çmimin 30 000 (tridhjetë mijë) lekë/m², me vlerë të përgjithshme 98 670 000 (nëntëdhjetë e tetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë; objekte me vlerë 15 340 387 (pesëmbëdhjetë milionë e treqind e dyzet mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 114 010 387 (njëqind e katërmëdhjetë milionë e dhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 435 000 (katërqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë, do të përballohen nga Autoriteti Portual Durrës.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 114 010 387 (njëqind e katërmëdhjetë milionë e dhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekësh, do të përballohet nga Autoriteti Portual Durrës.

6. Shpronësimi të fillojë më 1.10.2012.

7. “Albtelecom” sh.a. do të kompensohet për efekt shpronësimi, pasi të ketë dorëzuar, pranë Autoritetit Portual Durrës, dokumentacionin e plotë të pronësisë.

8. Autoriteti Portual Durrës do të likuidojë “Albtelecom” sh.a., sipas pikës 7 të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Portual Durrës, të fillojnë procedurat për kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit dhe në përgjegjësi administrimi të Autoritetit Portual Durrës.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës të pezullojnë të gjitha transaksionet për pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohet kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Autoriteti Portual Durrës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha